

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E MBROJTJES**  
**MINISTRI**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_. 2020

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**  
**(LOTI I)**

Për : Operatorin ekonomik "EUROVIA shpknj", me NUIS L91426009G  
Adresa: Rruga Abdyl Frashëri, Shkalla 1, Apartamenti 18, Zona Kadastrale 8270.

**Tiranë**

\* \* \*

Procedura e prokurimit : "Procedurë me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës".

Numri i referencës së procedurës : REF-54900-03-25-2020.

Numri i referencës së Lotit nr. I : REF-54902-03-25-2020.

Përshkrim i shkurtër i kontratës : "Blerje paketa ndihme për familjet në nevojë dhe materiale mbrojtëse në mbështetje të personelit të Forcave të Armatosura të angazhuar në përballimin e emergjencës së shkaktuar nga rënia e pandemisë së virusit COVID - 19", me fond limit total 146,845,000 (njëqind e dyzet e gjashtë milionë e tetëqind e dyzet e pesë mijë) lekë pa TVSH., ndarë në dy lote, si më poshtë:

- Loti nr. I, me objekt "Blerje paketa ndihme për familjet në nevojë për përballimin e emergjencës së shkaktuar nga rënia e pandemisë së virusit COVID - 19", për nevoja të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, me fond limit 105,780,000 (njëqind e pesë milionë e shtatëqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH;
- Loti nr. II, me objekt "Blerje materiale mbrojtëse për mbështetjen e personelit të Forcave të Armatosura të angazhuar në përballimin e emergjencës së shkaktuar nga rënia e pandemisë së virusit COVID - 19", për nevoja të SHPFA, me fond limit 41,065,000 (dyzet e një milionë e gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës : Duke filluar nga lidhja e kontratës me përfundim brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve.

Publikime të mëparshme : Nuk ka patur.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit : Çmimi më i ulët.

Njoftojmë se kanë qenë pjesëmarrës në procedurë (për Lotin nr. I), këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- Operatori ekonomik "EUROVIA shpknj", me NUIS L91426009G, me ofertë ekonomike me vlerë 101,430,000 (njëqind e një milionë e katërqind e tridhjetë mijë) lekë pa TVSH.

Janë s'kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm : Nuk ka ofertues të skualifikuar.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik "EUROVIA shpknj", me NUIS L91426009G dhe adresë: Tiranë, Rruga Abdyl Frashëri, Shkalla 1, Apartamenti 18, Zona Kadastrale 8270, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej 101,430,000 (njëqind e një

milionë e katërqind e tridhjetë mijë) lekë pa TVSH, është identifikuar si ofertë e suksesshme në lotin nr. I, me objekt "Blerje paketa ndihme për familjet në nevojë për përballimin e emergjencës së shkaktuar nga rënia e pandemisë së virusit COVID - 19", për nevoja të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, në procedurën e prokurimit me objekt "Blerje paketa ndihme për familjet në nevojë dhe materiale mbrojtëse në mbështetje të personelit të Forcave të Armatosura të angazhuar në përballimin e emergjencës së shkaktuar nga rënia e pandemisë së virusit COVID - 19".

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ministrisë së Mbrojtjes, me adresë: Rruga e Dibrës (ish shkolla e Bashkuar), Tiranë, me numër kontakti 042226601/2/3, 1320, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentet e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi. (Shënim. Formulari i sigurimit të kontratës të plotësohet në emër të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit).

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të zbatohen parashikimet e nenit 58 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë më datë : 26/03/2020.

Ankesa : Nuk ka patur.

## **TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**MINISTRI**

**Olta Xhaçka**